

Njoftim për kryerjen e mbikëqyrjes në Bashkinë Vau Dejës

Me urdhrin e brendshëm nr. 57, datë 22.05.2024, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes miratuar me Vendimin nr. 106, datë 15.12.2023 dhe në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ka nisur procesin e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimin në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Vau Dejës.